REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1330/2
Data / Datum / Date: 28 / 04 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

---

Nr. 73 /2026
Datë:28/04/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj, Fitore Gajtani-Avokate Shtetërore në Avokaturën Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, caktohet Ushtrues i Detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.
2. Zëvendësuesi/ja nga pika 1 e këtij vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij, t'i kryejë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr. 337/2025 i datës 23.07.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në përfundimin e procedurave të regrutimit por ju më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj.

A r s y e t i m

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt dhe të pandërprerë të Avokaturës Shtetërore, si institucion përgjegjës për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore, ndërmjetësim dhe arbitrazh, është e nevojshme caktimi i një Zëvendësuesi për pozitën e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.

Në pajtim me nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-227 për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore, Ndërmjetësim dhe Arbitrazh, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë. Deri në plotësimin e kësaj pozite, për të garantuar ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, është e nevojshme caktimi i përkohshëm i një zëvendësuesi.

Andaj, duke marrë parasysh kompetencën e Ministres së Drejtësisë dhe nevojën për funksionim të vazhdueshëm dhe efikas të Avokaturës Shtetërore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Znj. Fitore Gajtani;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm/MD;*
- *Avokaturës Shtetërore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*